



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.66/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Hajriz Hoti, e me procesmbajtësin Lirim Bektashi, në konfliktin administrativ të paditëses, Sh.G.nga L., të cilën me autorizim e përfaqëson K.A., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani ta paditëses dhe të autorizuarit të saj, e në mungesë të paditurës, me dt.10.10.2018, merr këtë,

A K T G J Y K I M

I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, Sh.G.nga L., anulohet vendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me nr.3920, i dt.10.08.2016 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të paditëses dhe të autorizuarit të saj, në mungesë të të paditurës, të thirrur në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i autorizuar e paditëses, K.A. në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, te dorëzuar në këtë gjykatë ashtu që vendimi i të paditurës i datës;10.08.2016 është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Skemat Pensionale, duke filluar nga dita e paraqitjes se ankesës. Lidhur me këtë çështje i ka propozuar gjykatës që të caktohet nga ekspertizë nga lëmia financiare i cili ka për të llogaritur pjesën e pagesës definitive nga data;27.01.2016, deri ne nxjerrjen e ekspertizës. Pas pranimit të përgjigjes në padi të paditurës e kundërshtojmë në tërësi si të pa bazuar deklaramet e të paditurës në përgjigjen në padi, për faktin se me asnjë prove nuk është vërtetuar se e paditësja nuk ka plotësuar kushtet për pension te parakohshëm. Andaj lidhur me këtë çështje në këtë seancë i dorëzohj edhe provat plotësuese, siq janë pasqyrat e trustit pensional, letrën konfirmimin e lëshuar nga AKP-ja me nr.1115/16 i dt. 27.05.2016 me te cilën vërtetohet përvoja e punës se paditëses nga data;31.03.1993, edhe një vërtetim i lëshuar nga Industria e Magnezit në G. të dt.31.03.1993.

E autorizuar e të paditurës, Avokatura Shtetërore, me përgjigjen në padi të dt.18.06.2018, e ka kontestuar në tërësi padinë e paditëses dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën që pas administrimit të provave, ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar, ndërsa vendimin e kontestuar, t'a lenë në fuqi, si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.10.10.2018, ka bërë administrimin e provave dhe atë, vendimet e të paditurës të dt.10.08.2016, dt.17.12.2015 dhe dt.18.06.2015, përgjigja në padi e të paditurës e dt.18.06.2018, certifikata e vendbanimit e datës;16.04.2015, certifikata e martesës e lëshuar nga Komuna e L. e dt.03.03.2011, ekstrakti nga libri amzë i te lindurve lëshuar nga zyra vendit G. e P. e dt.03.10.1979, raporti i QKMF- L. i dt.16.04.2015, letër konfirmimi i lëshuar nga AKP me dt.03.04.2015, formular për aplikim për vërtetimin mbi përvojën e punës e lëshuar nga AKP, kërkesa e paditëses drejuar të paditurës e dt.27.01.2016, aktvendimi i MIM G. e

dt.09.07.2001, vërtetimi i lëshuara nga e Miniera dhe Industria e Magurës e dt.12.02.2007, aktvendimi i OTHPS i dt.20.01.1987, libreza e punës me nr.11542 e lëshuar nga Komuna e L., formulari për aplikim në pension të parakohshëm i dt.20.04.2015, vlerësimi i Komisionit Mjekësor i të paditurës i dt.29.04.2015, pasqyra llogarisë së trustit të paditëses i dt.02.10.2018, letër konfirmimi i lëshuar nga AKP i dt.27.05.2015, pasqyra llogarisë bankare të paditëses e lëshuar nga R. e dt.10.05.2018, si dhe vërtetimi i lëshuar nga Miniera e G. në M. e dt.31.03.1993.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me nr.3920, i dt.10.08.2016, është refuzuar ankesa e paditëses Sh.G.e dt.27.01.2016 për njohjen e të drejtës në pension të parakohshëm.

Paditësja e pakënaqur me këtë vendim, me datë;13.01.2017, ushtron padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar rrjedhë se ai përmban të meta të tilla për shkak të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar.

Në arsyetimin e vendimit të organit të shkallës së dytë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Këshilli i ankesave ka shqyrtuar në tërësi shkresat e lëndës, vlerësimin e komisionit mjekësor të dt.29.04.2015, pretendimet ankimore në përputhje me pikën 1 dhe 2 të nenit 10 dhe ka konstatuar se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të qenë përfitues i pensionit të parakohshëm”.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, kur e refuzuar ankesën e paditëses, duke mos vlerësuar asnjë nga pretendimet e paditësit nga ankesa e dt.27.01.2016, e as provat e paditëses.

Gjykata verën se me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë vendimin e të paditurës të dt.18.06.2015, paditëses i është njohur e drejta në pension të parakohshëm nga data;20.04.2015 në shumë prej 105 euro për muaj, ndërsa me vendimin tjetër të paditurës të dt.17.12.2015, është shfuqizuar vendimi i dt.18.06.2015 dhe i është ndërprerë pagesa e mëtutjeshme e pensionit të parakohshëm me arsyetim se “Eshtë konstatuar se ju nuk i plotësoni kushtet dhe kriterët e parapara në pikën 2 të nenit 10 për pension të parakohshëm në kuptim të ligjit të cekur më lart”, duke mos e bazuar në asnjë provë të vetme këtë konstatim të tillë. Kjo për faktin se neni 10.4 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuar nga Shteti, janë përcaktuar kushtet se kur një personi i ndërpritet e drejtë në pension të parakohshëm siq janë “Pensionet e parakohshme do të ndërpriten së paguari, nëse personi:4.1. mbush moshën e pensionimit për realizimin e pensionit bazik të moshës;4.2. punësohet apo vetëpunësohet;4.3. ka përmirësime të gjendjes shëndetësore mbi pesëdhjetë përqind (50 %) ose; 4.4. vdes”. E nga provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, gjykata gjenë se nuk janë plotësuar këto kushte për ndërprerjen e këtij pensioni.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendosë në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se organi i paditur, nuk ka bërë fare arsyetim në vendimin e saj, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili ka përcaktuar se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve...etj”.

Gjykata ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditëses për nxjerrjen e provës me ekspertizë për të përcaktuar lartësinë e dëmit nga veprimet e të paditurës si të pa lejueshme, për faktin se në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes së kontestuar me padi, gjykata nuk ka autorizime ligjore që të vendosë meritorisht çështjen, por vetëm bën shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të kontestuar. Për këtë propozim, gjykata është e detyruar të vendosë vetëm në rast kur vetë e vendosë çështjen në pajtim me nenin 67.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se “Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, gjykata do ta anulojë aktin e kontestuar dhe, si rregull, vetë do të vendosë për çështjen me aktgjykim. Aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent”, dhe në këtë kuptim edhe një propozim të tillë e vlerëson si të pa lejueshëm.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë (30) ditësh në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.66/2017, dt.10.10.2018,

Procesmbajtës
Lirim Bektashi

G j y q t a r
Hajriz Hoti

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.